



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër i caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit kujdestar të Rexhep Selimit
Robert Karls

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkateswari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe me rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (përkatësisht "z. Thaçi", "z. Veseli", "z. Selimi" dhe "z. Krasniqi", dhe bashkërisht të përmendur si "të akuzuarit")².
2. Më 30 tetor 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar,³ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴
3. Më 4 dhe 5 nëntor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁵ z. Krasniqi, z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi u arrestuan⁶ dhe u transferuan në objektin e

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ("Vendimi i konfirmimit")*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

³ KSC-BC-2020-06, F00034/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i redaktuar publik i aktakuzës së konfirmuar, me korrigjimin e disa gabimeve në shkrim, u dorëzua më 4 nëntor 2020, F00045/A03, publik.

⁴ Vendimi i konfirmimit, para. 521(c)-(d).

⁵ KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e korrigjuara të Shtojcave 7 dhe 8 u protokolluan më 28 tetor 2020, përkatësisht me numrat F00027/A07/COR dhe F00027/A08/COR.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit të Jakup Krasniqit sipas rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; KSC-BC-2020-06, F00049, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit të Rexhep Selimit sipas rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00050, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit të Kadri Veselit sipas rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00051, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit të Hashim Thaçit sipas rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁷

4. Gjatë periudhës 9-11 nëntor 2020, u zhvilluan seancat e paraqitjes së parë për z. Krasniqi,⁸ z. Thaçi,⁹ z. Veseli¹⁰ dhe z. Selimi.¹¹ Gjatë seancave të paraqitjes së parë, të gjithë të akuzuarit deklaruan se kuptojnë dhe flasin shqip.¹²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. KONFERENCA PËR ECURINË E ÇËSHTJES

5. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë për ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve, dhe kur është e zbatueshme, mbrojtësit e viktimave, për të shpejtuar

⁷ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftimi i pranimit të Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; KSC-BC-2020-06, F00053, Administratorja, *Njoftimi i pranimit të Hashim Thaçit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00054, Administratorja, *Njoftimi i pranimit të Kadri Veselit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe i emërimit të mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00055, Administratorja, *Njoftimi i pranimit të Rexhep Selimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të*, 5 nëntor 2020, publik, para. 21(a). *Shih edhe* projekt-transkript, 9 nëntor 2020.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të*, 6 nëntor 2020, publik, para 20(a). *Shih edhe* projekt-transkript, 9 nëntor 2020.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih edhe* projekt-transkript, 10 nëntor 2020.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00061, Gjykatësi i procedurës paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih edhe* projekt-transkript, 11 nëntor 2020.

¹² KSC-BC-2020-06, projekt-transkript, 9 nëntor 2020, f. 4, rreshti 21 deri në f. 5, rreshti 2, f. 29, rreshtat 12-16; Projekt-transkript, 10 nëntor 2020, f. 59, rreshtat 18-22; Projekt-transkript, 11 nëntor 2020, f. 79, rreshtat 17-23.

përgatitjet për gjykim; dhe (ii) ndërmarrjen e hapave që garantojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

B. NXJERRJA E MATERIALEVE

6. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante, në posedim të ZPS-së, që janë në favor të të akuzuarit ose kundër tij i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizime rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në pajtim me rregullën 102 (3), ZPS-ja i dorëzon Mbrojtjes një njoftim të detajuar të çdo materiali dhe prove që ka në posedim.

7. Në pajtim me rregullën 102(1)(a) të Rregullores dhe në varësi të rregullave 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja vë në dispozicion të Mbrojtjes dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, materialin mbështetës për aktakuzën e konfirmuar si dhe çdo deklaratë të marrë nga i akuzuari sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda 30 ditësh nga paraqitja e parë.

8. Në pajtim me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja vë në dispozicion të Mbrojtjes materialin në vijim: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon të thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në gjuhën që të akuzuarit kuptojnë dhe flasin; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet ose transkriptet të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

9. Në pajtim me rregullën 102(2) dhe (4) të Rregullores, çdo deklaratë e dëshmitarëve shtesë të ZPS-së, që nuk është bërë e ditur brenda afatit 30-ditësh para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, i vihet në dispozicion Mbrojtjes, në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton dhe flet, sa më shpejt që të jetë e mundshme së bashku me arsyet për nxjerrjen

e vonuar të materialeve. Kjo nxjerrje e materialeve finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

10. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja vë në dispozicion çfarëdo deklarate, dokumenti dhe fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Prokurorit të Specializuar që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë apo i kanë përkitur të akuzuarit.

11. Në pajtim me rregullën 103 të Rregullores dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së.

12. Në pajtim me rregullën 107(1)-(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë konfidenciale *ex parte* trupit gjykues për t'u liruar tërësisht ose pjesërisht nga detyrimi sipas rregullave 102 dhe 103 të Rregullores për nxjerrjen e materialit fillestar nëse informacioni, të cilin e ka nën ruajtje ose kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja dhe për të cilin nuk ka marrë pëlqimin e dhënësit të informacionit për ta nxjerrë.

C. REDAKTIMET

13. Në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit dhe me rregullën 80(1) të Rregullores, një trup gjykues mund të urdhërojë masat e duhura për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët.

14. Në pajtim me rregullën 80(4)(a)(i)-(iii) dhe (d) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë redaktimin e emrave dhe të dhënave të tjera identifikuese në mënyrë që të parandalohet zbulimi i tyre për të akuzuarin dhe/ose publikun, sipas rastit, të identitetit dhe/ose të vendndodhjes së një dëshmitari, një viktime pjesëmarrëse në proces gjyqësor, ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër.

15. Në pajtim me rregullën 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë konfidencial *ex parte* trupit gjykues për mosnxjerrjen e informacionit përkatës, në tërësi ose pjesërisht, atëherë kur nxjerrja e një informacioni të tillë mund të dëmtojë, ndër të tjera, hetimet në kryerje e sipër ose hetime të ardhshme. Në pajtim me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

III. DISKUTIM

16. Në kuadër të paraqitjes së parë të të akuzuarve, procesi i nxjerrjes së provave dhe materialit për Mbrojtjen nga ZPS-ja pritet të fillojë pa vonesë, në pajtim me kornizën ligjore të lartpërmendur dhe me mënyrën dhe afatet që do të përcaktohen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Për të ndihmuar palët, sidomos Mbrojtjen, në procesin e nxjerrjes së materialeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes, siç parashikohet në rregullën 96 (1) të Rregullores, për paraqitjen e parashtrimeve lidhur me: i) materialet e specifikuara në shtojcën e këtij urdhri; ii) sistemin e redaktimit që do të miratohet në këtë proces, siç përcaktohet më tej në pikën 18 më poshtë; dhe iii) çdo temë tjetër relevante e cila nuk është përmendur në listën e materialeve në shtojcë, që palët e gjykojnë të nevojshme. Duke marrë në konsideratë parashtrimet e të gjithë mbrojtësve të të akuzuarve gjatë seancave të paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos të mbajë konferencën për ecurinë e çështjes më 18 nëntor 2020.

17. Gjithashtu, palët ftohen të dorëzojnë parashtrime me shkrim mbi pikat e renditura në shtojcën e këtij urdhri ose mbi tema të tjera relevante që ata i gjykojnë të nevojshme,

nëse dëshirojnë. Në rast se informacionet nuk mund të shkëmbehen me palën tjetër për arsye konfidencialiteti dhe mbrojtjeje, parashtrimet mund të dorëzohen me shkrim *ex parte*. Informacionet e ofruara nga palët do ta ndihmojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake në përpilimin e vendimit kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështjeve lidhur me to dhe mbi afatet përkatëse.

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron po ashtu të nevojshme të kërkojë dhënien e mendimeve me shkrim nga palët, në lidhje me sistemin e redaktimit të informacioneve dhe të provave që do të përdoret për këtë çështje gjyqësore sipas asaj që parashtrohet në “Vendimin kornizë për nxjerrjen e provave dhe për çështje të lidhura me të” në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05.¹³ Këto mendime do të shërbejnë si bazë informuese për Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin e sistemit të redaktimit, që do të sigurojë efikasitetin e procesit të nxjerrjes së materialeve, nëpërmjet arritjes së një drejtpeshimi midis detyrimit për të mbrojtur interesat e viktimave dhe të dëshmitarëve dhe respektimit të të drejtave të të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit.

19. Rikujtojmë këtu se, megjithëse të akuzuarit kanë të drejtën të jenë fizikisht të pranishëm në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores, duke mbajtur parasysh natyrën teknike të temave për diskutim, në konferencën për ecurinë e çështjes: i) mund të jetë fizikisht i pranishëm i akuzuari, ndërsa mbrojtësi merr pjesë nëpërmjet videokonferencës; ii) mund të jetë fizikisht i pranishëm mbrojtësi, ndërsa i akuzuari merr pjesë nëpërmjet videokonferencës; ose iii) mund të mos marrë pjesë i akuzuari, ndërsa mbrojtësi mund të jetë i pranishëm fizikisht ose të marrë pjesë nëpërmjet videokonferencës. Gjithsesi, për këto masa është i nevojshëm pëlqimi me shkrim i të akuzuarit, pasi të jetë këshilluar me mbrojtësin, në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores.

¹³ KSC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë për nxjerrjen e provave dhe për çështje të lidhura me të*, 9 tetor 2020, publik, para 73-89.

20. Nëse dëshirojnë të marrë pjesë në konferencën për ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës, mbrojtësit duhet t'i paraqesin kërkesë drejtpërsëdrejti Administratores, në pajtim me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për videolidhjen (KSC-BD-23/COR), brenda një kohe të mjaftueshme paraprake që do t'i jepte mundësi Administratores të ndërmerre hapat e duhur, përfshirë edhe informimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁴

IV. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të mbledhë një konferencë mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, në përputhje me pikën 16 më lart, **të mërkurën, më 18 nëntor 2020, në orën 11:00;**
- b. **KËRKON** nga ZPS-ja që të dorëzojë parashtrime me shkrim: i) për pikat e rendit të ditës së konferencës për ecurinë e çështjes, bashkëlidhur këtij urdhri; ii) për sistemin e redaktimit që do të zbatohet në këtë proces gjyqësor; dhe/ose për të tjera tema relevante që konsideron të nevojshme, deri **të premten, më 13 nëntor 2020;** dhe
- c. **KËRKON** nga Mbrojtja të dorëzojë parashtrime me shkrim: i) për pikat e rendit të ditës, bashkëlidhur këtij urdhri; ii) për sistemin e redaktimit; dhe/ose për tema të tjera relevante që konsideron të nevojshme, deri **të martën, më 17 nëntor 2020.**

/nënshkrim/

¹⁴ *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes*, 6 nëntor 2020, publik, para 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes*, 9 nëntor 2020, publik, para 9.

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 11 nëntor 2020
Hagë, Holandë.